



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:063942

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870712

KE.nr.2677/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Gjilanit të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M., kundër të paditurit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Driton Rexhepi, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,605.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 13.06.2023, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 27.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Komuna e Gjilanit, dhe DETYROHET i padituri Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A. që në emër të kompensimit të dëmit si pasojë e zjarrit të shkaktuar me datë 16.12.2015, në shkollën fillore të mesme të ulët "Vatra e Diturisë" në fshatin Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, t'ia paguaj paditësit në emër të dëmit si pasojë djegies së pajisjeve, shumën prej 805.00€ (tetëqind e pesë euro) me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, respektivisht 19.10.2016 deri në pagesën definitive të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Komuna e Gjilanit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri KEDS SH.A që t'ia paguaj paditësit në emër të dëmit si pasojë e djegies së 40 poçave elektrik shumën prej 800.00€ (tetëqind euro).
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi Komuna e Gjilanit me datën 19.10.2016, pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, ka paraqitur padi ndaj të paditurit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e incidentit të datës 16.12.2015 në SHFMU “Vatra e Diturisë” në Fshatin Livoç i Epërm ku si rezultat defektit në shtyllën elektrike kishte rezultuar me djegie pajisjeve të paditësit. Sipas padisë së paditësit, për shkak të mbitensionit ka ardhur deri tek djegia e pajisjeve të shkollës, andaj, mbi bazën ligjore të kompensimit të dëmit të shkaktuar si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme, ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurin t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar nga djegia e pajisjeve në vlerë prej 1,605.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Themelore në Gjilan, me Aktgjykimin C.nr.848/16 të datës 15.03.2024 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka detyruar të paditurin që paditësit si kompensoj dëmin në shumë të përgjithshme prej 1,380.00€ ndërsa ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjerët të kërkesëpadisë në shumën prej 200.00€.

Gjykata Komerçiale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr.404/22 të datës 03.11.2022, kanë aprovuar ankesën e të paditurit dhe ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerçiale të Kosovës.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë duke shtuar se për shkak të prishjeve-avarisë e cila ka ndodhur në shtyllën elektrike prej nga furnizohet kjo shkollë ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit material në disa pajisje shkollore. Në seancën e datës 13.06.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv me të cilën ka kërkuar nga gjykata që për dëmin e shkaktuar në Power Motherboard for Ricoh Afico MPC2500 shumën prej 300.00€, për dëmin e shkaktuar në Roller Ricoh shumën prej 100.00€, për dëmin e shkaktuar në Display Motherboard Rico shumën prej 100.00€, për dëmin e shkaktuar në shtëpizën e kompjuterit, (Pc Corei5-5400,8GBRAM,120HB SSD) shumën prej 280.00€, për dëmin e shkaktuar në modem (Router TP-Link) shumën prej 25.00€ dhe për dëmin e shkaktuar në 40 poça elektrik shumën prej 800.00€, në shumë totale prej 1,605.00€ me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë.

I padituri përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimin gjyqësorë në rigjykim ka deklaruar se Komisioni Profesional i të paditurës me 16.12.2015 kanë dal në vendin e ngjarjes ku kishin konstatuar dhe kishin vërejtur se nga përçuesi i neutral apo zero punuese, shkollës fillore i janë djegur fotokopjuesi, kompjuteri dhe një modem, mirëpo në procesverbalin e hartuar nga Komisioni Profesional i KEDS nuk është vërtetuar se me fajin e KEDS janë djegur edhe 40 poçe elektrike në shkollën fillore. Paditësi në këtë padi thirret vetën në procesverbalin e KEDS ndërsa nuk ka prezantuar asnjë provë material si foto dokumentacion përveç dy oferta të marra nga dy kompani për rastin i cili ka ndodhur në 2015 ndërsa oferta e Pro Computers është lëshuar me datën 05.02.2016, ndërsa paditësja nuk ka sjell asnjë provë bindëse për ta vërtetuar lartësinë dhe atë fatura të bashkangjitura dhe kuponin fiskal për ta vërtetuar lartësinë e dëmit. Po ashtu ka theksuar se çdo pajisje elektrike posedon mbrojtësin elektrik edhe pse këto pajisje të lartcekura nga energjia elektrike kanë mundur të pësojnë ndonjë defekt apo djegie por në asnjë mënyrë nuk kanë mundur të djegën në tërësi dhe se, mirëpo paditësja asnjëherë nuk ka tentuar dhe gjykatës nuk i ka sjellë provë që ka tentuar që të riparojë. Tutje, ka shtuar se konsiderojmë se deklarata e drejtorit F.M. në këtë çështje juridike është subjektive dhe është kontradiktore me procesverbalin e punuar nga KEDS po ashtu duke u bazuar në kodin e shpërndarjes të aprovuar nga ZRRE përgjegjësia e furnizuesit operatorit shtrihet deri tek njëtori elektrik pika matëse por jo edhe në brendësi të shtëpisë, objektit në instalimet e brendshme elektrike andaj ne si palë e paditur i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj si të pa bazuar dhe propozojmë që të nxjerrët një ekspertizë e re nga fusha e elektroteknikes. Në fund ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadi të refuzohet si e pabazuar si dhe kërkuar shpenzimet për pagesën e ekspertizës në shumë prej 300 euro.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Proces nr.1161 i dt.26.01.2016; Kërkesë drejtuar zyrës ligjore të Komunës së Gjilanit i dt.14.10.2016; Ofertë lëshuar nga Eurodex për SHF. “Vatra e Diturisë”; Ofertë lëshuar nga Pro Computers me dt.05.02.2016; Kontrata për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak të dt.16.12.2015; Vërejtje e dt.23.11.2026; Raporti i ekspertizës së elektros i hartuar nga eksperti N.K. dorëzuar në Gjykatë me dt.15.07.2020; Ekspertiza nga lëmia e makinerisë nga eksperti B.H. e datës 08.05.2024; Dëshmia e dëshmitarëve M.R. dhe F.M. e dhënë në procesverbalin e dt.04.03.2021; Shikohen 4 fotografi.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 16.12.2016 në SHFMU “Vatra e Diturisë” në fshatin Livoç i Epërm në Komunën e Gjilanit për shkak të defektit në shtyllën elektrike është shkaktuar dëm në disa pajisje të shkollës.

Nga Procesverbali nr.1161 i datës 26.01.2016, gjykata ka konstatuar se komisioni i themeluar nga KEDS dhe i përbërë nga S.S., M.R. dhe Ali Rexhepi ka dalë në vendimin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se në shkollë është djegur një fotokopjues, një kompjuter si dhe një modem. Si dhe ka konstatuar se në shtyllën elektrike prej nga furnizohet me energji kjo shkollë përcuesi i neotrit (zeros punuese) nuk ka qenë i shtrënguar mirë.

Nga Kërkesa drejtuar zyrës ligjore të Komunës së Gjilanit i datës 14.10.2016, gjykata konstaton se drejtori i SHFMU “Vatra e Diturisë” me datën 14.10.2016 ka kërkuar nga Komuna e Gjilanit për përfaqësim të shkollës në gjykatë për dëmet e shkaktuara nga rryma si shkak i defekteve në rrjet he dëmet të shkaktuar në vlerë prej 500 euro për fotokopjues, 880 euro për ndriqim të shkollës, 200 euro për punë dhe ndrim apo shumën e përgjithshme prej 1,580 euro.

Nga Oferta lëshuar nga “Eurodec” për SHFMU “Vatra e Diturisë”, gjykata ka konstatuar se “Eurotec” i kishte bërë ofertë shkollës për 40 llampa neoni me çmim prej 22.00€ në vlerë totale prej 880.00€.

Nga Oferta lëshuar nga Pro Computers datës 05.02.2016, gjykata konstatoi se D.P.T. “Pro-Computers” me datën 05.02.2016 i kishte bërë ofertë për Power motherboard for RICOH AFICO MPC2500, Hot roller dhe Thermistor Display Motherboard në vlerë totale prej 500.00€.

Nga Kontrata për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak e datës 16.12.2015, gjykata konstatoi se mes KEDS dhe SHFMU ka pasur kontratë të lidhur për furnizim me energji elektrike;

Nga Raporti i ekspertizës së elektros i hartuar nga eksperti N.K. i datës 15.07.2020 gjykata konstaton se zjarri i shkaktuar me datën 12.2015 në SHFMU “Vatra e Diturisë” në Fshatin Livoç i Epërm ka ardhur si pasojë e energjisë elektrike dhe atë për shkak të lidhjes së dobët të përcuesit të neutritit (zeros përcuese) ku është paraqitur tensioni 380-400V në vend të tensionit 220-240V

dhe se domeni i përgjegjësisë për problemet me energjinë elektrike të rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike deri te njehsori i konsumatorit bie mbi kompaninë e distribuimit të energjisë elektrike.

Nga Ekspertiza nga lëmia e makinerisë për vlerësim e dëmit e hartuar prej Ekspertit B.H., e pranuar në Gjykatë më datë 08.05.2024, gjykata konstatoi se eksperti i makinerisë pas vlerësimit të pajisjeve të dëmtuara për shkak të prishjeve-avarisë e cila ka ndodhur në shtyllën elektrike prej nga furnizohet kjo shkollë ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit material në disa pajisje shkollore dhe atë llampa neoni 120x40 në vlerë prej 800€, një Power Motherboard for Ricoh Afico MPC2500 në vlerë prej 300€, një Roller Ricoh në vlerë prej 100€, një Display Motherboard Rico në vlerë prej 100€ (të tri këto pjesë përbërëse të fotokopjesit), një shtëpizë e kompjuterit Pc Corei5-5400,8GBRAM,120HB SSD në vlerë prej 280€ dhe një modem (Router TP-Link) në vlerë prej 25€.

Nga Dëshmia e dëshmitarëve M.R. dhe F.M. e dhënë në procesverbalin e dt.04.03.2021 pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, gjykata konstatoi se M.R. ka qenë anëtar i komisionit profesional të krijuar nga KEDS për rastin në fjalë dhe pas daljes në vendin e ngjarjes kanë konstatuar se janë shkaktuar dëme materiale dhe atë një fotokopjues, një kompjuter dhe një modem ndërsa sa i përket ndriçimit për të njëjtat nuk është njoftuar nga stafi për prishjen e tyre, kurse nga deklarata e F.M. gjykata konstatoi se i njëjti ka qenë mësimdhënës në SHFMU “Vatra e Diturisë” dhe se ka dëshmuar se me datën 15.12.2015 ka pasur probleme me shtyllën elektrike.

3. Baza ligjore

Nga faktet e vërtetuara, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit.

Po ashtu gjykata vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive pasi që i padituri ushtron veprimtari e cila kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar të dëmit andaj gjeti se gjejnë zbatim nenit 136 par.2 i LMD-së i cili përcakton se: “2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.” neni 154 i LMD-së i cili përcakton se: “Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.” dhe neni 155 i LMD-

së i cili përcakton se: *“Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.”*

Lidhur me bazën për kompensimin e dëmit gjykata vlerësoi se gjen zbatim nenit 136 par. 1 i LMD-së i cili përcakton se: *“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* dhe neni 137 i LMD-së i cili përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”* dhe nenin 173 par. 1 dhe 2 të LMD-së që përcaktojnë se: *“1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër.”*

Sa i përket kamatës ligjore, gjykata zbatoi dispozitat e nenit 382 të LMD-së i cili përcakton se: *“1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër.”*

4. Vlerësimet e gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për faktin se nga provat e administruara është vërtetuar se deri te djegia pajisjeve në SHFMU “Vatra e Diturisë” ka ardhur si pasojë e defektit në shtyllën elektrike, i cili defekt ishte shkaktuar nga përçuesi i neutritit (zeros përçuese) i cili nuk ka qenë i shtrënguar mirë, ashtu që me rastin e ndërprerjes së zeros së rrjetit, paditësi është furnizuar me tension linjor (380-4000V) dhe nuk është furnizuar me tension monofazor (220-240V) dhe kjo ka rezultuar në djegien e pajisjeve elektrike që kanë qenë të kyçura në rrjetin elektrik.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin ekspertizës elektrike të përgatitur nga N.K. e datës 15.07.2020 nga e cila konstatoi se zjarri i shkaktuar me datën 12.2015 në SHFMU “Vatra e Diturisë” në Fshatin Livoç i Epërm ka ardhur si pasojë e energjisë elektrike dhe atë për shkak të lidhjes së dobët të përçuesit të neutritit (zeros përçuese) ku në të gjithë konsumatorët një fazor paraqitet tensioni 380-400V në vend të tensionit 220-240V ashtu që ky tension është i pa përballueshëm për të gjitha këto pajisje. Ndërkaq thekson se nëse vie deri tek problemi me zeron e përçuese

atëherë ekzistojnë gjasa të mëdha për dëmtimin e pajisjeve elektrike të cilat janë të kyçura në rrjetin elektrik si pasojë e rritjes së nivelit të tensionit në rrjetin e furnizimit. Ndërsa gjykata nuk i fali besimin lidhur me konstatimet lidhur me lartësinë e dëmit në pajisjet elektrike pasi që gjykata vlerësoi se nuk është në kompetencën e ekspertit të elektros përcaktimi i lartësisë së dëmit në pajisje elektrike, për çfarë gjykata kishte nxjerrë ekspertizën nga lëmia e makinerisë.

Gjykata ia fali besimin edhe ekspertizës së makinerisë të punuar nga eksperti B.H. nga e cila konstatoi se për zëvendësimin e të gjitha pajisjet e dëmtuara për shkak të energjisë elektrike me pajisje me performanca të ngjashme ka vlerësuar se vlera e çmimit për Power Motherboard for Ricoh Afico MPC2500 është në shumë prej 300.00€, për Roller Ricoh është në shumë prej 100.00€, për Display Motherboard Rico është në shumë prej 100.00€ (të tri këto pajisje pjesë përbërëse të fotokopjuesit), për shtëpizën e kompjuterit, (Pc Corei5-5400,8GBRAM,120HB SSD) është në shumë prej 280.00€, për modemin (Router TP-Link) është në shumë prej 25.00€ dhe për 40 poça elektrik është në shumë prej 800.00€, në shumë totale prej 1,605.00€. Sa i përket dëmit të shkaktuar të 40 poçave elektrik i njëjti ka konstatuar se në procesverbalin e KEDS ato nuk kanë qenë të evidentuara, mirëpo i ka përfshirë në ekspertizë duke u bazuar në deklaratën e drejtorit të shkollës dhe në ekspertizën nga lëmia elektrike, andaj gjykata në këtë rast nuk morri parasysh dëmin lidhur me ndërrimin e 40 poçave elektrik pasi që për të njëjtët nuk gjeti prova të cilat mbështesin pretendimin e paditësit se janë djegur si pasojë e problemit me zeron punuese në shtyllën elektrike të ndodhur me datë 16.12.2015.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se në përputhje me nenin 136 par.2 të LMD-së, i padituri mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurit dhe se dëmi është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike, gjatë furnizimit të rregullt të paditësit dhe duke marrë për bazë faktin se djegia e pajisjeve elektrike ka ndodhur në procesin e furnizimit të paditësit me energji elektrike përkatësisht si pasojë e problemit me zeron në shtyllën elektrike nga e cila është furnizuar me energji elektrike paditësi dhe në faktin se furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike paraqet veprimtari të rrezikshme, andaj rrjedh se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësinë objektive për shkaktimin e dëmit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar bie mbi të paditurin, sepse veprimtaria të cilën e ushtron i padituri kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila dallon nga veprimtaritë tjera, gjatë ushtrimit të cilave nuk ekziston fare rrezik nga shkaktimi i dëmit. Vet fakti se veprimtaria e të paditurit përbën veprimtari të tillë, mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plotë dhe gjatë së cilës, në çdo moment dhe në çdo kohë, pa asnjë lëshim të

asnjërës palë, mund të paraqitet rreziku dhe mund të shkaktohen aksidente me pasoja të rënda, e kualifikon veprimtarinë e të paditurit si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila krijon përgjegjësi për të gjitha dëmet e shkaktuara që rezultojnë apo ndërlihdën me energjinë elektrike, pavarësisht nga faji (përgjegjësi objektive).

Për më tepër gjykata vlerëson se i padituri, duke marr për bazë faktin se njëjta ushtron veprimtari me rrezik të shtuar ka qenë e obliguar që të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e çfarëdo rrezikut që vjen nga energjia elektrike përfshirë këtu edhe rregullimin e zeros (përçuesit neutral) në shtyllën elektrike.

Prandaj, bazuar në nenin 154 të LMD-së, gjykata vlerëson se në veprimtarinë me rrezik të shtuar, rreziku dhe përgjegjësia supozohen andaj çdo dëm i pësuar nga këto veprimtari, bie në përgjegjësi të ushtruesit të veprimtarisë së tillë dhe se përgjegjësia e të paditurit për dëmin e shkaktuar mund të shmanget, vetëm nëse i padituri e provon se dëmi nuk është shkaktuar nga energjia elektrike, apo nëse përkundër faktit se ka marrë të gjitha masat e duhura, dëmi nuk do të mund të mënjanohej në asnjë mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se dëmi ka ndodhur absolutisht pa fajin e tij dhe se nuk ka mundur ta parashoh dhe as ta parandalojë atë, si dhe të provojë se dëmi ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit e që në rastin konkret, nga vetë procesverbali i hartuar nga zyrtarë të paditurit kanë konstatuar se përçuesi i neutral (zero punuese) nuk ka qenë i shtrënguar mirë nga çfarë ka ardhur edhe deri tek shkaktimi i dëmit tek paditësi andaj në kuptim të nenit 155 të LMD-së, i padituri është përgjegjës për dëmin që ka pësuar paditësi.

Rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në dispozitat ligjore të cituara ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e palës paditëse është pjesërisht e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke u bazuar në ekspertizën e makinerisë së punuar nga eksperti B.H., ku është vërtetuar se vlera e dëmit të shkaktuar në pajisje është 805.00€, shuma këto të cilat sipas vlerësimit të gjykatës, gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës dhe atë në Procesin nr.1161 të datës 26.01.2016 të përgatitur nga Komisioni i Profesional i KEDS në të cilën janë përshkruar pajisjet e dëmtuara të vërejtura pas daljes në vendin e ngjarjes.

Ndërkaq, sa i përket konstatimit të vlerës së dëmit në kohën e shkakimit të dëmit dhe jo sipas ofertave të vitit 2016, gjykata ia fali besimin mendimit profesional të ekspertit B.H., meqenëse

është e pamundur që të caktohet saktësisht vlera e dëmit pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me pajisje të përdorura dhe duke analizuar çmimin e tregut tani me çmimin ofertave të marra në kohën e afërt me kohën kur ka ndodhur ndërrimi ka vlerësuar se vlera totale e pajisjeve është e njëjtë siç është e prezantuar si në ekspertizë kjo në përputhje edhe me nenin 173 par.2 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit ashtu që i njohu shpenzimet e vetëm për pajisjet e dëmtuara të përcaktuara me procesverbalin nr.1161 të datës 26.01.2016, ndërsa refuzoj pjesët tjetër të kërkesëpadisë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi mbi shumën e aprovuar sa i përket dëmit të shkaktuar për 40 poça elektrik për shkak se gjykata nuk gjeti prova të besueshme që vërtetojnë faktin se të njëjtat janë dëmtuar si rezultat i problemit të ndodhur me datë 16.12.2015.

Gjykata provat tjera të administruara lidhur me këtë çështje juridike, i ka vlerësuar mirëpo ka gjetur se të njëjtat nuk kanë ndikim për vendosje në këtë çështje juridike

5. Kamata ligjore dhe Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit të dëmit, paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 19.10.2016 e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që vendosi që secila palë të bart shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2677/22, datë 27.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.